



## VENDIM

Nr. 21, Datë 26.06.2012

### **PËR DISA MODALITETE MBI PËRFUNDIMIN E STUDIMEVE NGA STUDENTËT QË NUK KANË SHLYER DETYRIMET PËR MARRJEN E DIPLOMËS, PËR EFEKT TË KALIMIT NË SISTEMIN E STUDIMEVE 3+2 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 26.06.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e anëtarëve, në bazë të nenit 39 të Statutit të Universitetit të Arteve,

## VËREN SE

Rektori i Universitetit të Arteve, duke pasur në konsideratë faktin se disa studentë në të tre Fakultetet e Universitetit të Arteve, nuk kanë përfunduar ende studimet e filluara me sistemin 4 vjeçar, ka përcaktuar disa procedura lidhur me krijimin e mundësive për këta studentë që të vazhdojnë dhe përfundojnë studimet. Më konkretisht është përcaktuar që:

1. Në secilin Fakultet të Universitetit të Arteve ngrihet një Grup për Vlerësimin e Krediteve (GVK) të fituara gjatë studimeve të deritanishme nga studentët.
2. GVK përbëhen nga tre persona: dy Përgjegjësit e Departamenteve të secilit Fakultet dhe një person i caktuar nga Dekani i Fakultetit. Anëtarët e GVK duhet të kenë së paku titullin akademik "Profesor i Asociuar". GVK ngrihet me Urdhër të Dekanit.
3. GVK, pasi njihet me studimet e kryera nga studentët, sipas Fakulteteve përkatëse, bën vlerësimin e krediteve të fituara prej tyre, gjatë kohës së studimeve, duke përcaktuar kreditet e fituara për çdo lëndë të studiuar dhe të shlyer nga studentët. Në përfundim të vlerësimit GVK harton një raport të detajuar lidhur me vlerësimin e kryer, në të cilin të bëhet përkthimi veçmas për secilin student. Relacioni në fund duhet të përmbajë edhe një analizë lidhur me përshtatshmërinë e krediteve të fituara me studimet e sistemit 3+2.
4. GVK duhet të paraqesë Rektorit relacionin përkatës brenda datës 20.06.2012.
5. Dekanët e Fakulteteve dhe Sekretarët e Fakulteteve do të ndihmojnë GVK në ushtrimin e detyrave të tyre, si dhe do të vendosin në dispozicion çdo dokument që kërkohet.
6. Ngarkohen Dekanët e Fakulteteve, Sekretarët e Fakulteteve si dhe anëtarët e GVK, për zbatimin e këtij urdhri.

Për sa më sipër del e nevojshme përcaktimi i modaliteteve për përfundimin e studimeve nga an e këtyre studentëve, në përputhje me gjetjet e GVK-ve në Fakultete. Për këto arsye Senati Akademik i Universitetit të Arteve

## VENDOSI

1. Studentët e përcaktuar nga GVK për të cilët është bërë vlerësimi i krediteve dhe është përcaktuar përshtatshmëria për vazhdimin e studimeve, kanë të drejtë të regjistrohen në vitin e studimeve të ciklit të dytë, për të cilin kanë plotësuar numrin e krediteve të kërkuara.



2. Regjistrimi i tyre do të bëhet në përputhje me modalitetet e regjistrimit që ndiqen në Universitetin e Arteve. Studentët do të vazhdojnë të ruajnë të njëjtin numër amze / numër matrikullimi, që kanë marrë në kohën e regjistrimit për herë të parë në Universitetin e Arteve.
3. Me fillimin e studimeve, studentët e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi do të kenë të njëjta të drejta si studentët e tjerë dhe do të kenë detyrimin që lidhet me tarifën vjetore të shkollimit.
4. Diploma që u lëshohet studentëve në përfundim të studimeve është në përputhje me Diplomat përkatëse që lëshon Universiteti i Arteve.
5. Studentët që kanë pasur detyrime të pashlyera dhe që kanë zgjedhur vazhdimin e studimeve para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk përfitojnë nga ky Vendim.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE